



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/265
Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti të mbledhjes së 264-t të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/265
Datë: 01.08.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 587,569€ (pesëqind e tetëdhjeteshtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetenëntë euro) në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me kod 221, nënprogrami "Administrata Qendrore" me kod 11321, nga kategoria e investimeve kapitale, konkretisht nga projekti "Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar" me kod 18782, në 5 (pesë) projekte kapitale në pajtim me Marrëveshjet e Mirëkuptimit për bashkëfinancim të projekteve të nënshkruara nga Ministri i Zhvillimit Rajonal dhe kryetarët e komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga projekti i investimit kapital "Programi për Zhvillim Rajonal", me kod 18782, në këto projekte, me shumat e cekura si në vijim:
 - 2.1. "Rrethoja e Çelikut - Ura e madhe e Sitnicës - Komuna Vushtrri" - Komuna e Vushtrrisë, në shumë prej 100,000€ (njëqind mijë eurosh);
 - 2.2. "Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit" - Komuna e Gjilanit, në shumë prej 219,569€ (dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetenëntë eurosh);
 - 2.3. "Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik në Komunën e Junikut" - Komuna e Junikut, në shumë prej 90,000€ (nëntëdhjetë mijë eurosh);
 - 2.4. "Shëtitorja dhe parku rekreativ te liqeni i Zubin Potokut - Hapësirë për pushim, turizëm dhe komunitet" - Komuna e Zubin Potokut, në shumë prej 80,000€ (tetëdhjetë mijë eurosh);
 - 2.5. "Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e komuniteteve" - Komuna e Rahovecit, në shumë prej 98,000€ (nëntëdhjetetë mijë eurosh).
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/265
Datë: 01.08.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48, paragrafi 3, të Ligjit për Statistikat Zyrtare Nr. 04/L-036, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M
Për emërimin e Këshillit Statistikor

1. Emërohet Këshilli Statistikor (Këshilli) dhe përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve, si në vijim:
 - 1.1. Avni Kastrati - Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
 - 1.2. Blerta Kika - Përfaqësuese e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 1.3. Valbone Dushi - Përfaqësuese e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
 - 1.4. Enver Mekolli - Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
 - 1.5. Merita Berisha - Përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë;
 - 1.6. Vedat Sagonjeva - Përfaqësues i Zyrës për Planifikim Strategjik, ZKM;
 - 1.7. Edona Sekiraga - Përfaqësuese e Bankës Qendrore;
 - 1.8. Agron IJamiti - Përfaqësues i Administratës Tatimore të Kosovës;
 - 1.9. Flaka Azemi - Përfaqësuese e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 1.10. Adelina Maksuti - Përfaqësuese e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - 1.11. Ardiana Gashi - Përfaqësuese e Universitetit.
2. Në takimin e parë Këshilli emëron një përfaqësues nga qendrat kërkimore dhe një përfaqësues nga komuniteti i biznesit.
3. Të gjithë anëtarët e Këshillit emërohen për një periudhë pesë (5) vjeçare.
4. Këshilli vepron në bazë të rregullave procedurale, të cilat miratohen brenda 3 (tre) muajve pas emërimit të Këshillit.
5. Këshilli emëron kryesuesin dhe një zëvendëskryesues nga radhët e anëtarëve të tij.
6. Këshilli i kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe rregullat përkatëse procedurale, të cilat miratohen nga Këshilli.
7. ASK-ja e mbështet teknikisht edhe përmes administratës veprimtarinë e Këshillit.

8. ASK-ja i financon aktivitetet e Këshillit nga buxheti i vet.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/265
Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, nenit 16 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Hysen Muzliukaj, emërohet në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjat (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/265
Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294, nenit 16 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Shemsi Duriqi, emërohet në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjat (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/265
Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 13 të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil

1. Z. Besim Kamberaj, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, i emëruar nga Qeveria me Vendimin Nr. 20/223, të datës 9 tetor 2024, pezullohet sipas detyrës zyrtare nga marrëdhënia e punës për shkak se ndaj tij është ngritur aktakuzë për procedurë penale, për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
2. Pezullimi nga pika 1. e këtij Vendimi do të zgjasë deri në përfundimin e procedurës penale.
3. Në përputhje me nenin 71, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi, gjatë kohës së pezullimit si në pikën 2. të këtij Vendimi, përfiton 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/265
Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen projektet kapitale: 1. Renovimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, me kod 14227; 2. Lokaliteti Dresnik, me kod 14026; 3. Renovimi i Ndërtesës së Arkivit Shtetëror të Kosovës, me kod 15501; 4. Renovimi i Stadiumit të Podujevës, aktualisht në kodin 12424 (Renovimi i Stadiumeve ekzistuese të Futbollit në qendrat regjionale), në organizatën buxhetore Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kod 207, si projekte shumëvjeçare, sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
2. Obligimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që mjetet buxhetore shlesë të nevojshme për të arritur totalin në vlerë prej 28,000,000€ (njëzetetë milionë euro) 1. Renovimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës 22,000,000€ (njëzetëdy milionë euro); 2. Lokaliteti i Dresnik 2,500,000€ (dy milionë e pesëqind mijë euro); 3. Renovimi i Ndërtesës së Arkivit Shtetëror të Kosovës 1,500,000€ (një milion e pesëqind mijë euro); 4. Renovimi i Stadiumit të Podujevës, në kuadër të projektit Renovimi i Stadiumeve ekzistuese të Futbollit në qendrat regjionale 2,000,000€ (dy milionë euro) për realizimin e projekteve për vitet fiskale përtej periudhës trevjeçare të mbuluar me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, t'i përfshijë brenda kufijve të vet buxhetorë për secilin vit përkatës fiskal.
3. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/265
Datë: 01.08.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumë prej 296,488.24€ (dyqind e nëntëdhjetëgjathtë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro e njëzetekatër centë) për komunat Podujevë dhe Shtime, për përfundimin e projekteve me klauzolë të investimeve (fondi burimor 06).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nga nënprogrami "Huamarrja për projekte potenciale brenda MFPT-së, kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale", me kod 48900, nga projekti "Kontingjenca për Klauzolë të Investimeve" me kod 15045, dhe ndahen për komunat si vijon:
 - 2.1. Në Komunën e Podujevës (615) ndahet shuma 178,730.00€ (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqindetridhjetë euro), në nënprogramin "Infrastruktura Publike", me kod 18165, në projektin "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza - Podujevë" me kod 49125, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" - Përmes Klauzolës së Investimeve;
 - 2.2. Në Komunën e Shtimes (617) ndahet shuma prej 117,758.24€ (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro e njëzetekatër centë), në nënprogramin "Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik" me kod 48007, në projektin "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza, Shtime", me kod 49126, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale" - Përmes Klauzolës së Investimeve.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Komuna e Podujevës dhe ajo e Shtimes për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/265

Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2024.
2. Raporti nga pika 1. e këtij Vendimi i procedohet për shqyrtim dhe aprovim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/265
Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 14, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, dhe në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:


V E N D I M

1. Aprovohet riallokimi i mjeteve në shumë prej 3,000,000.00€ (tre milionë euro), në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, nënprogrami "Projektet e Bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale", me kod 42000, nga kategoria e shpenzimeve kapitale, konkretisht nga projekti kapital "Programi i Bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale", me kod 10041, në 28 (njëzetetë) projekte kapitale të reja, në përputhje me memorandumet e mirëkuptimit për projekte kapitale, të nënshkruara nga Ministri i MMPHI-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga projekti kapital "Programi i Bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale", me kod 10041 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
 - 2.1. Asfaltimi i rrugës Kamenicë - Moqare - Berivojcë, Komuna e Kamenicës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
 - 2.2. Asfaltimi i rrugëve në Hodonovc, Roganë dhe Muqivërc, Komuna e Kamenicës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
 - 2.3. Asfaltimi i rrugëve në Kamenicë dhe Topanicë, Komuna e Kamenicës, alokimi për vitin 2025, vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
 - 2.4. Asfaltimi i rrugëve "Adem Jashari", "Tahir Sinani", "Hysiqi" dhe "Berlini", Komuna e Shtimes, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
 - 2.5. Asfaltimi i rrugës së Topillës, Carralevë - Zborc dhe Rancë - Greiçevc, Komuna e Shtimes, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
 - 2.6. Rivitalizimi i rrugës "Ibrahim Shabani" - Vojnovc, Komuna e Shtimes, alokimi për vitin 2025, në vlerë 120,000€ (njëzet mijë euro);
 - 2.7. Rikonstruimi i rrugës "Ekrem Rexha - Drini", në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, alokimi për vitin 2025, në vlerë 232,500€ (dyqind e tridhjetedy mijë e pesëqind euro);
 - 2.8. Ndërtimi i rrugëve: "Mulla Idrizi", "Lidhja e Prizrenit", "Xheladin Kurbaliu dhe Skifter Arifi", "Pajazit Ahmeti", Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2025, në vlerë 288,000€ (dyqind e tetëdhjetetë mijë euro);

- 2.9. Ndërtimi i rrugëve "Abdulla Presheva, Agim Rashiti dhe Skender Berisha", "Vëllezërit Frashëri, Fatmir Ibishi dhe Nijazi Kadriu", "Haki Myderizi, Fatos Limani, Sylejman Ashkiu"; Rrethrotullimi - "Nyja Kryesore, Rruga e Prishtinës - Rruga Qarkore", Komuna e Gjilanit, alokimi për vitin 2025, në vlerë 250,000€ (dyqind e pesëdhjetë mijë euro);
- 2.10. Rikonstruimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet: "Bahri Fazliu, Agron Rrahmani, Ali Ajeti, 19 Qershori dhe Bedri Bajrami", me gjatësi totale L=1,770 m, si dhe ndërtimi i Urës mbi lumin Llap, rrugë lidhëse me rrugën Nacionale N25 - Podujevë, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 300,000€ (treqind mijë euro);
- 2.11. Ndërtimi i rrugës Orllan - Rakinicë dhe i rrugës "Rubiku" në Orllan, me gjatësi L=5,030 m, si dhe ndërtimi i trotuarit të ura në Orllan, me gjatësi L=300 m, Komuna e Podujevës alokimi për vitin 2025, në vlerë 200,000€ (dyqind mijë euro);
- 2.12. Ndërtimi i rrugëve Lluga - Bellopojë dhe Siboc - Dumosh, L=2,600 m, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
- 2.13. Ndërtimi i rrugëve në fshatin Sylevicë dhe Tërnavicë, L=6,000 m, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
- 2.14. Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Bajqinë, Dobërdol, Pakashticë, Metehi, Dumnicë, Bellopojë, Brainë, Tërnavë, Llapashticë, Gllamnik, Sfeqël, Dumosh dhe rrethinë, Komuna e Podujevës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
- 2.15. Asfaltimi i rrugëve: Deçan, Isniq, Strelle i Epërm, Strelle i Ulët, Dubovik, Prapaqan, Pobërgj, Lloqan, Voksh, Drenoc, Prejlep, Baballoq, Broliq, Carrabregu i Epërm, Carrabregu i Ulët, Dashinoc, Dubravë, Glllogjan, Gramaqel, Hulaj, Irzniq, Lëbushë, Prekolluk, Rastavicë, Shaptej, Sllup, Vranic i Vogël, Kodrali, Ratishi i Epërm dhe Ratishi i Ulët, Komuna e Deçanit, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
- 2.16. Asfaltimi i rrugëve në Bajgorë, Rashan, Tërstenë, Kutllovc dhe Vllahi, Komuna e Mitrovicës së Jugut, alokimi për vitin 2025, në vlerë 100,000€ (njëqind mijë euro);
- 2.17. Rregullimi me zhavorr i rrugëve: "Krtina", "Mala Groblja", "Stara Moravska", "Bara-Blato", "Blato", "Crkovina - Iravac - Mogilla - Groblje" dhe ndërtimi i kanalizimit fokal në fshatrat Vërbovc dhe Mogillë, Komuna e Klllokotit, alokimi për vitin 2025, në vlerë 99,500€ (nëntëdhjetenëntë mijë e pesëqind euro);
- 2.18. Rindërtimi me asfalt i rrugës Klinë - Shtupel - Binxhë - Grapc, Komuna e Klinës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 30,000€ (tridhjetë mijë euro);
- 2.19. Rindërtimi me asfalt i rrugëve në fshatin Sferkë, Komuna e Klinës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 30,000€ (tridhjetë mijë euro);
- 2.20. Ndërtimi i rrugës "Smajl Bica", me gjatësi L=358 m; Komuna e Istogut, alokimi për vitin 2025, në vlerë 50,000€ (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.21. Rehabilitimi, zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës "Azem Behluli", "Behlul Behluli", Rrezë Malit dhe rikonstruimi i shtresës qarkulluese të rrugëve "Rugova", "Rexhë Bytyqi" dhe "Afërdita" në Mushtisht, Komuna e Suharekës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 65,000€ (gjashtëdhjetepesë mijë euro);
- 2.22. Ndërtimi i parkut afër objektit të komunës së Mitrovicës Veriore, në rrugën "Çlirimi", Komuna e Mitrovicës së Veriut, alokimi për vitin 2025, në vlerë 41,600€ (dyzetënjë mijë e gjashtëqind euro);
- 2.23. Asfaltimi i rrugës në Bresje, Komuna e Graçanicës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 50,000€ (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.24. Ndërtimi i rrugës Fortesë - Celinë, Komuna e Rahovecit, alokimi për vitin 2025, në vlerë 50,000€ (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.25. Rikonstruimi i rrugës Druar - Pestovë, aneksi 2, Komuna e Vushtrrisë, alokimi për vitin 2025, në vlerë 50,000€ (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.26. Rikonstruimi i rrugës "Hamdi Gashi", Komuna e Vushtrrisë, alokimi për vitin 2025, në vlerë 50,000€ (pesëdhjetë mijë euro);
- 2.27. Asfaltimi i rrugës që lidh qytetin e Vushtrrisë me fshatin Skoçan, Komuna e Vushtrrisë, alokimi për vitin 2025, në vlerë 50,000€ (pesëdhjetë mijë euro);

- 2.28. Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugëve "Kultur", "Pasha" dhe Demirci", në Mamushë, Komuna e Mamushës, alokimi për vitin 2025, në vlerë 43,400€ (dyzetetrec mijë e katërqind euro).
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/265

Datë: 01.08.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14 dhe 23, të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme për ndarje të mjeteve buxhetore, në shumë prej 40,000.00€ (dyzet mijë eurosh) për mbulimin e shpenzimeve financiare për familjarët e zjarrfikësve të rënë në detyrë, si vijon:
 - 1.1 Kaqun Lima, Udhëheqës togu në Njësinë e Zjarrfikësve në Gjakovë, i lindur më 24 janar 1963, data e vdekjes 8 korrik 2025, në shumën prej 20,000.00€ (njëzet mijë eurosh);
 - 1.2 Sefadin Osmanaj, Zjarrfikës i Njësisë së Zjarrfikësve në Klinë, i lindur më 17 korrik 1972, data e vdekjes 8 gusht 2024, në shumën prej 20,000.00€ (njëzet mijë eurosh).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren si vijon:
 - 2.1 Nga Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 232, nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara", me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva", shuma prej 20,000.00€ (njëzet mijë eurosh);
 - 2.2 Nga nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", shuma prej 20,000.00€ (njëzet mijë eurosh), në kuadër të masës 3.6 të Programit të Ringjalljes Ekonomike.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi transferohen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
4. Obligohet Thesari që të realizojë transferin e mjeteve sipas pikës 1. të këtij Vendimi, në llogarinë bankare të caktuar nga familjarët e Kaqun Limës dhe Sefadin Osmanajt, të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.
5. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/265
Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform kërkesave të legjislacionit në fuqi për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/265
Datë: 01.08.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 3, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruar nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor dhe nenin 42, paragrafi 3, të Kodit Nr. 08/L-247 Doganor dhe të Akcizave, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 gusht 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për aplikimin e tatimit doganor me normë zero (0%) për mallrat e importuara me origjinë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. Origjina e mallrave nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshmohet përmes certifikatës së origjinës të lëshuar në përputhje me rregullat e origjinës të përcaktuara në legjislacionin doganor në fuqi të të dyja vendeve.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Dogana e Kosovës dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e pikës 1. dhe 2. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë